LINPROJEKT

Architektur | Raumentwicklung | Verkehr | Landschaft | Umwelt
metron



Plani Zhvillimor Komunal - Mitrovicë

II.

Vizionet, Parimet dhe Synimet

2.1 Vizioni për të ardhmen e Komunës së Mitrovicës

Zhvillimi i vizionit për komunën e Mitrovicës është bazuar në vizionin e dhënë për këtë regjion sipas Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) dhe vizionet që kanë dalë nga punëtoritë e organizuara me një pjesëmarrje të gjerë të administratës komunale, shoqërisë civile, komunitetit etj. (punëtoritë 3 dhe 4 të zhvilluara gjatë procesit të hartimit të planeve).

Vizioni për regjinion e Mitrovicës sipas PHK:

“Thesari i Kosovës” Zonë e zhvilluar industriale që merr rolin udhëheqës në industrinë e rëndë e përpunuese të mineraleve me mbajtjen dhe kultivimin e traditave të lashta, duke respektuar standardet për mjedis ekologjik, zhvillim të agrobiznesit, tregtisë e industrisë shërbyese, rritjen e kualitetit të jetës, punësimit dinamik, barasië sociale përmes qeverive lokale, aktive e perkrahëse, transparente e efektive.

Bazuar në këtë, gjatë punëtorive të mbajtura janë ofruar edhe ide të ndryshme lidhur me të ardhmen e komunës dhe qytetit të Mitrovicës;

Qendër multietnike me një rrezatim regjional dhe internacional falë shkollave të larta, ofertës kulturore (muzikë, sport) dhe trashëgimisë kulturore.

Qendër kryesore e arsimit në veriun e Kosovës për shkollim të lartë dhe profesional.

Vend turistik me turizëm të zhvilluar malor me shëtitore; turizëm të minierave si dhe me një trashëgimi multi kulturore si pika atraktive për vizitorë

Nyje e re tregtare me theks të veçantë në tregti, logjistikë dhe shërbime në nyjën e komunikacionit në Mitrovicë; pikë kyçe për tregti me Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë, Maqedoninë dhe Greqinë.

Duke marrë parasysh kontekstin e ndërlikuar politik dhe rrethanat e kushtet e përgjithshme që janë në lidhshmëri me njëra tjetrën (mundësia për rifunksionaliziimin e prodhimtarisë së xehes dhe përpunimin e metaleve, potenciali për zhvillimin e turizmit), shanset për një zhvillim vlerësohet të jenë në potencialin e një qendre multietnike e lidhur me opsionet e qytetit të arsimit të lartë si dhe në lëmin e tregtisë dhe bujqësisë.

Bazuar në këtë deklarata e vizionit për komunën dhe qytetitn e Mitrovicës është:

“Qendër regjionale ekonomike me industri, blegtori, tregti dhe turizëm të zhvilluar e ndërtuar në traditën e bashkëjetesës multietnike dhe asaj arsimore duke ofruar një mjedis të shëndoshë e të sigurtë për të gjithë”. .

2.2 Parimet e përgjithshme për zhvillim/mbrojtje

Krijimi i një ambienti të shëndoshë dhe të qëndrueshëm për banim , punë dhe rekreim për të gjithë qytetarët është moto e cila do të sillet rreth parimeve të përgjithshme për zhvillim . Plani zhvillimor i Komunës së Mitrovicës do të bazohet në parimet e përgjithshme si :

- promovimin e ngritjes së kualitetit të jetës dhe formave të balancuara të vendbanimeve;
- promovimin e ekonomisë stabile me të drejta të barabarta për të gjithë mitrovicasit dhe uljen e shkallës së papunësisë
- Promovimin e interesave të përbashkëta të banorëve të Mitrovicës duke mbrojtur resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndru eshëm;
- PZHK mbështet parimin e qasjes e integuar, duke përfshirë elementet e transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën;
- Parimi i subsidiaritetit: plani duhet të ketë parasysh kontekstin e gjerë hapësinor. Sipas parimit të subsidiaritetit, plani duhet të fokusohet në çështjet lokale, mirëpo mos të jetë kontradiktor me çështjet e nivelit të lartë;
- Plani duhet t'i paraprijë zhvillimit strategjik në territorin e komunës dhe të trajtojë çështjet e rëndësisë strategjike për fushat përkatëse;
- Plani merr parasysh parimet e njohura ndërkombëtarisht si ato të qeverisjes së mirë urbane: promovimin e pjesëmarrjes publike dhe gjithpërfshirjes; barazisë; promovimin e transparencës në planifikim si dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme etj.
- PZHK së Mitrovicës theks të vecantë i jep parimit të zhvillmit kompakt dhe të balancuar me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të hapësirës duke insistuar gjithnjë në një shpërndarje të barartë të funksioneve themelore të zhvillimit në mënyrë që të eliminohen disparitetet në zonat ku ato janë më të shprehura sidomos ato rurale dhe të mbrohet toka bujqësore

2.3 Synimet zhvillimore

Në bazë të „fushave të veprimit“ të dala nga faza e Analizës, janë përpunuar synimet zhvillimore, të cilat u diskutuan dhe u plotësuan gjatë organizimit të punëtorisë së katërt, punëtori e cila ishte gjithëpërfshirëse dhe masovike në aspektin e përfaqësimit.

2.3.1 Synimet kryesore

Synimi kryesor i planeve hapësinore (PZhK / PZhU) është një zhvillim urban i qëndrueshëm d.m.th. ekonomik, social dhe ekologjik. Me PZhK / PZhU do duhej të paraqiten bazat dhe kushtet si dhe hapat e nevojshëm dhe masat për 20-30 vitet e ardhshme.

A	**Komunë multietnike** Mitrovica, një hapësirë për jetesë: Bashkëjetesa në qetësi dhe siguri në qytetin multietnik duhet të jetë më se prioritare dhe duhet edhe më tutje të avancohet. Bazë për këtë është komunikimi, participimi, bashkëpunimi dhe toleranca. Në kuadër të planifikimit të PZhU, ky bashkëpunim në mes të grupeve të ndryshme etnike për fat të keq nuk ishte i suksesshëm. Mirëpo PZhU-ja prapseprapë duhet të ofrojë hapësira dhe vendtakime për të gjitha grupet etnike në të gjitha pjesët e qytetit.
B	**Qendër regjionale ekonomike në veri të Kosovës** Me qëllim të rritjes së mundësisë për ofrimin e vendeve të punës në veri të Kosovës, duhet të bëhen parakushtet hapësinore e infrastrukturore. Gjatë kësaj duhet të shkohet kah një ekonomi e shumëllojshme. Potencialet reale të një zhvillimi industrial (Trepça) duhet të sqarohen.Njëkohësisht duhet përkrahur zhvillimin e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla (NMV) . Qëllimi është zhvillimi ekonomik i cili do të krijonte dhe ofronte vende të punës për të gjitha grupet etnike.
C	**Infrastruktura sociale, teknike dhe e komunikacionit** Shtrirja, zgjerimi dhe përmirsimi i infrastrukturës sociale , infrastrukturës teknike dhe komunikacionit si dhe ofrimi i qasjes më të lehtë të qytetarve në këto shërbime .
D	**Ambienti dhe kualiteti i jetesës** Përmirësimi i gjendjes së ambientit, zvogëlimi i ndotjeve të ambientit, sanimi i mbeturinave industriale, mbrojtja e bazës për një jetë ekologjike
E	**Zhvillimi i qëndrueshëm i vendbanimeve** Me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve / hapësirave natyrore, tokës pjellore duhet synuar zhvillim të kontrolluar , kompakt dhe të balancuar të vendbanimeve përmes shfrytëzimit racional të tokës / trollit .
F	**Zhvillimi i zonave rurale** Zhvillimi ekonomik i zonave rurale në favor të ruajtjes së tokës bujqësore dhe mbrojtjes së trashigimisë natyrore dhe kulturore si resurse të rëndësishme për zhvillim dhe qëllim të frenimit të migrimit fshat-qytet. Shanseve në lëmin e bujqësisë dhe turizmit duhet tu epet shtytje.

2.3.2 Synimet e pjesërishme

A Komunë multietnike

A.1	Lehtësimi i kthimit të përndjekurve në vatrat e veta përmes masave të ndryshme për integrim në mes të grupeve të ndryshme etnike (Agjenda Zhvillimore Komunale e Mitrovicës)
A.2	Të nxiten kontaktet dhe bashkëpunimi ndërmjet grupeve etnike.
A.3	Ruajtja e dygjuhësisë në qytet
A.4	Të krijohen hapësira/zona të cilat do të mund të shfrytëzohen nga të gjitha grupet etnike për zhvillimin/shkëmbimin e tyre kulturorë, ekonomik dhe social

B Qendër regjionale ekonomike në veri të Kosovës

B.1	Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës
B.2	Sigurimi i sipërfaqeve/hapësirave për zonat industriale dhe të zanateve
B.3	Qartësimi i bazës juridike për planifikim dhe investime (përmes Rregulloreve për çështje pronësore, shfrytëzimit dhe ndërtimit)
B.6	Bërja e parakushteve për rinisjen e nxjerrjes së xeheve nëntokësore
B.8	Vazhdimësia dhe koordinimi i instrumenteve për nxitje të zhvillimit ekonomik
B.10	Shfrytëzimi i hapësirave pran lumenjve për projekte ekonomike (p.sh. rritja e peshkut, etj.)

C Infrastruktura sociale, teknike dhe e komunikacionit

C.1 Infrastruktura sociale (arsimi, shëndetësia)

C.1.1	Ruajtja dhe identifikimi i sipërfaqeve rezervë për objekte infrastrukturore të së ardhmes (shkollat, objektet shëndetësore)
C.1.2	Ruajtja dhe përmirësimi i gjendjes së objekteve shkollore/arsimit
C.1.4	Ruajtja dhe zgjerimi decentral i shërbimit të shëndetësisë
C.1.5	Përmirësimi i shfrytëzimit të spitalit në veri të qytetit të Mitrovicës
C.1.6	Ofrimi i shërbimeve sociale më të mira për gjithë banorët e Mitrovicës
C.1.7	Ofrimi i kuadrit arsimor / personelit shëndetësor në vendet ku ka mungesë të madhe
C.1.8	Ngritja e kualitetit të kuadrit mësimor dhe shëndetsor përmes programeve trajnuese të bazuara në kërkesa / nevoja .

C.2 Infrastruktura teknike

C.2.1	**Shtrirja dhe zgjerimi i infrastrukturës teknike (rrjeti energjetik, telefonia, ujësjellësi dhe kanalizimi) në ato zona ku kjo infrastrukturë mungon dhe në zonat të cilat deri tani kanë qenë më dobët të përfshira .**
C.2.2	**Mirëmbajtja e rrjetit ekzistues dhe sigurimi i alternativave tjera për furnizim me energji elektrike (energjia e ujit, erës, diellit)**
C.2.3	**Sigurimi i alternativave për furnizim me ujë të pijshëm .**

C.3 Infrastruktura e komunikacionit

C.3.1	**Mobilitet për të gjithë (të rinj, pleq, të hendikepuar, këmbësorë, biçiklistë, përdorues të trafikut urbanë, komunikacioni individual)**
C.3.3	**Përmirësimi i rrjetit ekzistues të komunikacionit dhe ofrimi i saj aty ku mungon.**
C.3.7	**Përmirësimi i lidhjeve infrastrukturore me regjionin e Shalës së Bajgorës me qëllim të nxitjes së turizmit**
C.3.8	**Përmirësimi i lidhjeve rrugore në mes të 26 fshatrave, ndërtim selektiv i rrugëve.**
C.3.9	**Zhvillimi i koordinuar i vendbanimeve dhe infrastrukturës rrugore.**

D Ambienti dhe kualiteti i jetesës

D.1	**Mbrojtja e peizazhit, rritja e kualitetit/atraktivitetit përgjatë brigjeve të lumenjve.**
D.2	**Përmirësimi i gjendjes ekzistuese në hapësirat publike të qytetit**
D.3	**Përmirësimi i gjendjes së ambientit, sanimi i deponive (të mbetjeve të plumbit, etj)**
D.4	**Mbrojtja e peizazhit , florës dhe faunës**
D.5	**Mbrojtja e monumenteve kulturore dhe objekteve të kultit**
D.5	**Mbrojtja e tokës bujqësore dhe pyjeve**

E Zhvillimi i qëndrueshëm i vendbanimeve

E.1	Dendësimi i brendshëm e sipërfaqeve banuese, sidomos në zonat me infrastrukturë ekzistuese
E.3	Identifikimi i kufijve të vendbanimeve nëpër fshatra
E.4	Kufizimi dhe dendësimi i vendbanimeve dhe mbrojtja e peizazhit (zona të mbrojtura) si dhe zonave bujqësore
E.5	Përcaktimi i nënqendrave duke përfshirë edhe funksionet dhe detyrat
E.7	Përmirësimi i standardit të banimit
E.8	Mbrojtja e zonave të pandërtuara nga ndërtimet e paligjshme (parandalimi)

F Zhvillimi i zonave rurale

F.1	Shëndrrimi i bujqësisë nga subsistenca në prodhimtari për treg
F.2	Sigurimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore posaçërisht në rrafshet përgjatë lumenjve sie dhe në zonën rreth fshatit Vllahi. Përparimi në lëmin e prodhimtarisë së drithërave dhe perimeve.
F.3	Përdorim i matur i hapësirës pran lumenjve për projekte ekonomike (p.sh. rritja peshkut)
F.4	Nxitja e zhvillimit të blegtorisë dhe prodhimi dhe përpunimi i qumështit në zonën rurale kodrinore.
F.5	Zgjerim i lehtë i zonës rekreative rreth Bajgorës (zonë kodrinore-malore) dhe në mes të Vinarcit dhe Zhabarit (zonë përgjatë lumit).
F.6	Mbrojtja e pyjeve dhe ripyllëzimi
F.7	Emërimi i zonës në veri të Bajgorës si zonë e mbrojtur natyrore
F.8	Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit

2.4 Prioritetet strategjike

Në Agjendën Zhvillimore Komunale (Nëntor 2006), komuna ka përcaktuar fushat strategjike zhvillimore të komunës dhe qytetit. Këto paraqesin një bazë të mirë për prioritetet strategjike . **Fushat strategjike zhvillimore të komunës së Mitrovicës** (sipas Agjendës Zhvillimore Komunale, Nëntor 2006) :

I	Zhvillimi dhe përmirësimi i gjendjes së ambientit si dhe infrastrukturës komunale
II	Kthimi i të përndjekurve në vendet/shtëpitë e tyre
III	Zhvillimi i shëndetësisë
IV	Zhvillimi i arsimit
V	Përparimi i kulturës, rinisë dhe sportit
VI	Përmirësimi i shërbimeve/përkujdesjes sociale, posaçërisht për të përndjekurit
VII	Zhvillimi dhe përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
VIII	Përparimi dhe zgjerimi i kooperimit në mes të grupeve të ndryshme etnike



Fushat strategjike zhvillimore të Agjendës Zhvillimore Komunale 2007 – 2009, janë në përputhshmëri të plotë me planifikimet e deritanishme të PZhK-së dhe PZhU-së si dhe do të kihen parasysh gjatë procesit të mëtutjeshëm të planifikimit.

Nga data 11 - 15 janar 2007, në Shkup të Maqedonisë u mbajt Punëtoria (Workshopi) i përbashkët i përfaqësuesve të pjesëve jugore dhe veriore të qytetit të Mitrovicës. Qëllimi i Punëtorisë ishte që të sjellin ide për përmirësimin e kushteve të jetesës në tërë qytetin e Mitrovicës (veri dhe jug). Kriza ekonomike dhe kushtet e këqija për jetesë të njerëzve në veri dhe jug të qytetit, ishin pikënisjet për ndërtimin e dialogut ndërmjet pjesëmarrësve në dialog .

Pesë tema të rëndësishme

Pjesëmarrësit e Punëtorisë formuluan pesë tema të cilat, sipas tyre, janë më të rëndësishmet për Mitrovicën : Zhvillimi ekonomik, ambienti i shëndoshë, Infrastruktura dhe mobiliteti, shërbimet publike si dhe ndërtimet e objekteve publike, kualiteti dhe identiteti urban .

Caqet afatmesme dhe afatgjata

Si caqe apo projekte afatshkurta dhe afatmesme, u përmendën këto: Revitalizimi i zonës industriale dhe asaj për rekreacion, Industri e pastër, Rindërtimi, Sistem i ri i kanalizimit, Revitalizimi i shtretërve të lumenjve, Parqe të vogla në qendër (3 pemë/drunj për kokë banori), Zhvillim turistik (liqeni i Gazivodës dhe regjioni i Shalës), Ngritja e vlerës së rrugëve, Futje e një sistemi për parkim, Stacioni i autobusëve dhe trenit, Vendparkingje në kuadër të tregut, infrastruktura sociale si dhe shkollat e çerdhet e reja, Ngritja e vlerës së pjesëve në zonën rurale dhe Organizime kulturore.

Si caqe apo projekte afatgjata, u përmendën këto: Treni i shpejtë, Ngritja e nivelit të rrugëve apo autoudhë të reja, Treni lokal, Bibliotekë e re e qytetit, Rrjet rrugorë për biçiklistë.

Në dy Punëtorit informale (Workshope), të mbajtura në Janar të vitit 2008 nga UN-Habitat-i, murrën pjesë përfaqësues të pjesës veriore dhe jugore të qytetit. Në këto Punëtori poashtu u diskutuan projektet me prioritet.

Përfaqësues të pjesës jugore theksuan këto prioritete :

- Masat që duhet ndërmarrë për zgjidhjen e problemit të mbeturinave të rrezikshme (9)
- Ndërtimi i një spitali (5)

- Rritja e kapaciteteve përpunuese të impianteve për përpunimin e ujit dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit (6)
- Përmirësimi i rrjetit furnizues me energji elektrike (4)
- Zhvillimi i zonave për aktivitete ekonomike (3)
- Përkrahja e prodhimtarisë bujqësore , si p.sh. rritja e gjedheve (3)
- Rregullimi dhe përmirësimi i parkingjeve (3)

Përfaqësues të pjesës veriore theksuan këto prioritete :

- Rimëkëmbja e pjesëve t kompleksit industrial Trepça dhe destinimi i tyre për aktivitete të ndryshme ekonomike (6)
- Studimet e fizibilitetit përfshirë edhe opsionet financiare për zona të ndryshme si Shala, Rogozna, Kopaoniku, liqeni i Gazivodës (3)
- Rritja e kapaciteteve përpunuese të impianteve për përpunimin e ujit dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit (3)
- Largimi i objekteve ilegale (3)
- Zhvillimi i zonave për aktivitete ekonomike (2)
- Sanimi dhe zgjerimi i rrjetit të rrugëve (2)
- Zhvillimi i punëtorive publike (2)
- Ndërtimi i një impianti për kullimin e ujërave të zeza (2)
- Rindërtimi i varrezave ortodokse (2)
- Zhvillimi i arealeve për sport dhe rekreacion (2)

Nisur nga projektet e përmendura, del se si në veri ashtu edhe në jug të qytetit ka një vetëdije të ngjashme rreth problemeve të qytetit, ani pse shihen disa dallime në vënien e prioriteteve. Si të përbashkëta mund të përmenden :

- Masat që duhet ndërmarrë për zgjidhjen e problemit me mbeturinat e rrezikshme / ¨Rimëkëmbja e pjesëve të kompleksit industrial Trepça dhe destinimi i tyre për aktivitete të ndryshme ekonomike
- Rritja e kapaciteteve përpunuese të impianteve për përpunimin e ujit dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit
- Zhvillimi i zonave për aktivitete ekonomike

Më tutje gjatë zhvillimit të Punëtorisë u parashtruan dhe vlerësuan projekte të veçanta në lëmë të ndryshme (zhvillimi i ri ekonomik, kualiteti ekologjik, infrastruktura dhe mobiliteti, kualiteti urban dhe identiteti).

Njohurit e fituara nga këto punëtori u futën në procesin e planifikimit të PZhU-së dhe PZhK-së.